

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarif a
822/5	18.06.2021	Kerkese per korigjim emertimi per emertimin e baneses monument kulture.	01.07.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, rreth çështjes për emërtimin e objektit pasuri kulturore “Banesa e Faik Belaj dhe Vasil Papadhopolit”, Gjirokastrë, Ju bëjmë me dije se: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) është në proces të zhvillimit të projektit “Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Integruar të Qendrave Historike Berat dhe Gjirokastrë – pasuri botërore në seri”. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 169, datë 20.02.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”, kapitulli III, Pika 2.c) “përmbajtja e planit të menaxhimit trajton, por pa u kufizuar, çështjet, si përshkrim të hollësishëm të pasurisë kulturore, vlerat, gjendja e konservimit të tyre, karakteristikat, integriteti, autenticiteti, kufijtë, koordinatat gjeografike, të dhëna hartografike, të dhëna vizuale (fotografi ose skica) statusi ligjor që mbron pasurinë, çështje që lidhen me administrimin dhe udhëzime për adresimin e tyre”. Për sa më sipër, ky proces do të përfshijë verifikimin e gjendjes fizike, të dhënat për pasuritë kulturore brenda qendrës historike, si edhe identifikimin e këtyre të fundit me kode.	E plote	JO
822/6	23.06.2021	Delegim kerkese nga MK lidhet me kerkesen nr Prot. 822/5.	01.07.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, rreth çështjes për emërtimin e objektit pasuri kulturore “Banesa e Faik Belaj dhe Vasil Papadhopolit”, Gjirokastrë, Ju bëjmë me dije se: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) është në proces të zhvillimit të projektit “Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Integruar të Qendrave Historike Berat dhe Gjirokastrë – pasuri botërore në seri”. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 169, datë 20.02.2020 “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”, kapitulli III, Pika 2.c) “përmbajtja e planit të menaxhimit trajton, por pa u kufizuar, çështjet, si përshkrim të hollësishëm të pasurisë kulturore, vlerat, gjendja e konservimit të tyre, karakteristikat, integriteti, autenticiteti, kufijtë, koordinatat gjeografike, të dhëna hartografike, të dhëna vizuale (fotografi ose skica) statusi ligjor që mbron pasurinë, çështje që lidhen me administrimin dhe udhëzime për adresimin e tyre”. Për sa më sipër, ky proces do të përfshijë verifikimin e gjendjes fizike, të dhënat për pasuritë kulturore brenda qendrës historike, si edhe identifikimin e këtyre të fundit me kode.	E plote	JO
1093	22.06.2021	Delegim kerkese/ankese nga MK per pronen ne Shkoder.	23.06.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : Me kërkesë datë 25.05.2021, administruar në IKTK me Nr. 905 Prot., datë 25.05.2021, Znj. A. Bekteshi shpreh shqetësimin për ndërhyrjet të cilat çënojnë banesën e familjes së saj (pasuri kulturore), dhe IKTK me shkresë Nr.	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>905/1 Prot., datë 31.05.2021, kthen përgjigje duke përcjelle shkresën ku qytetari vihet në dijeni për masat e marra nga DRTK Shkodër.</p> <p>Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër ka përcjellë me shkresë Nr. 145/1 Prot., datë 26.05.2021, administruar në IKTK me Nr. 923 Prot., datë 28.05.2021, kërkesën drejtuar Z. B. Kurtbegu, për pezullim punimesh për ndërhyrjet e sistemit dhe shtrimit të oborrit, ndërhyrje e cila cënon catinë e pasurisë kulturore të sipërcituar.</p> <p>Me datë 04.06.2021, pranë IKTK përcillet ankesa Nr.348155 ( Platforma e Bashkëqeverisjes) nga Znj. A. Bekteshi rreth shqetësimit për ndërhyrjet që po bëjnë pasurinë kulturore. Me datë 07.06.2021m IKTK ka përcjellë në platformën e Bashkëqeverisjes, shkresën Nr. 905/1 Prot., datë 31.05.2021 me përgjigjen për problematikën e qytetarit.</p> <p>Me datë 15.06.2021, pranë IKTK është administruar ankesa e qytetarit Z.B Kurtbegu me Nr. 1046 Prot., datë 15.06.2021 mbi pezullimin e punimeve të kërkuar nga DRTK Shkodër. Me shkresë Nr.1046/1, IKTK ka përcjelle pranë DRTK Shkodër kërkesën e qytetarit për kompetencë me qëllim verifikimin e situatës në terren.</p> <p>Për sa më sipër informojmë se ndjekja e çështjes së sipërcituar është në proces nga organet kompetente.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni kopje të :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Kthim përgjigje Nr.905/1 Prot., datë 31.05.2021 ;</li> <li>-Shkresës Nr. 145/1 Prot., datë 26.05.2021 ;</li> <li>-Kërkesës Nr.1046 Prot., datë 15.06.2021 dhe kthim përgjigje Nr. 1046/1., datë 23.06.2021.</li> </ul>		
1046/2	01.07.2021	Kerkese per rivleresim ne terren te gjendjes se objektit.	02.07.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Pas ankesës verbale nga qytetari Z.B Bekteshi me dt.26.05.2021, specialistët e DRTK-Shkodër kanë inspektuar pasurinë kulturore, banesa e Ramiz Bekteshit, monument kulture i kategorisë së I-rë, shpallur me datë 08.01.1977.</p> <p>Motivi i ankesës ishte punime pa leje nga Z.B Kurtbegu, fqinji në perëndim të objektit. Nga inspektimi i kryer rezultoi se ndërhyrja që po bëhet nga komshiu është ngritja e një strukture metalike, profilet të së cilës janë në afërsi 2-3cm nga fasada e pasme e objektit.</p> <p>Përafërsisht 1.5-2m kjo strukturë futet nën catinë e objektit, pasuri kulturore, përkatësisht në murin e jashtëm të dhomës nga e cila ka marr statusin objekti. Gjithashtu gjatë inspektimit në banesën e Besnik Kurtbegu u konstatua se qytetari po sistemonte oborrin, përmes shtrimit të tij me cimento deri në murin e objektit pasuri kulturore.</p> <p>Inspektimi është kryer në prani të Policisë e cila ka asistuar të gjithë procesin e inspektimit, ndërsa Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit refuzoi hyrjen në banesë.</p> <p>Në vijim të shkresës me Nr.145/1 Prot., datë 26.05.2021 administruar dhe protokolluar nga DRTK-Shkodër me anë të së cilës institucioni ynë ka kërkuar pezullimin e punimeve dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të punimeve të kryera nga Z.B Kurtbegu, përmes së cilës janë vënë në dijeni Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Shkodër, Prefekti i Qarkut Shkodër, Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.</p>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>Z.Kurtbegu i është drejtuar institucionit tonë me anë të nje ankese “Saktësim i konstatimeve të bëra nga specialistët e DRTK-Shkodër në pronën time me dt.26.05.2021”.</p> <p>DRTK-Shkodër me shkresën nr.145/3, datë 03.06.2021 ku qytetari i është thënë se DRTK-Shkodër gjatë inspektimit ka evidentuar punime të realizuar nga ana e tij.</p> <p>Gjithashtu i është bërë me dije se DRTK-Shkodër është institucion i cili ushtron detyrën në mbrojtjen e pasurive kulturore nën administrimin e saj dhe si e tillë DRTK-Shkodër shqyrton vetem situatat ku rrezikohen pasuritë kulturore.</p> <p>Gjithashtu DRTK-Shkodër e ka orientuar Z.Kurtbegu që për të bërë ndërhyrje në afërsi të kësaj pasurie kulturore duhet të hartohet një projekt dhe të përcillet për mendim me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pranë institucionit tonë.</p> <p>Pranë institucionit tonë është administruar shkresa me nr.148/2 prot., datë 03.06.2021 protokolluar nga DRTK-Shkodër me nr 145/5, datë 08.06.2021 e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, nga ku i kërkohet IMT, zbatim i përgjegjësive dhe detyrave, marrjen e masave të nevojshme për strukturën metalike në fjalë si dhe të përcillet informacioni i plotë dhe i detajuar pranë IKMT-së .</p> <p>Shkresa e DRTK-Shkodër me nr.145/1, datë 26.05.2021 për pezullim punimesh dhe kthim në gjendjen e mëparshme nuk është zbatuar nga Z.Kurtbegu.</p> <p>Gjithashtu ju informojmë se Z.Kurtbegu ka ngritur një kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me objekt paligjshmërinë e shkresës me nr 145/1 prot, datë 26.05.2021 të DRTK-Shkodër, paligjshmërinë e shkresës nr 148 prot, datë 03.06.2021 të IKMT-Drejtoria Rajonale Shkodër, Pezullimin e veprimeve nga ana e tyre deri sa të zgjidhet gjyqësisht kjo çështje.</p> <p>Seanca e parë për masën e sigurimit të padisë është realizuar me datë 29.06.2021 nga ku Gjykata rrëzoi kërkesën për masën e sigurimit të padisë, si të pabazuar në ligj dhe prova.</p> <p>Gjithashtu Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër me anë të shkresës nr.22/6 (XH.Z), të datës 22.06.2021, administruar nga DRTK-Shkodër me nr.182.3 prot, datë 22.06.2021, ka komunikuar se në lidhje me shtetasin B.Kurtbegu është rregjistruar kallëzimi 616.21 dhe ndodhet në fazë vlerësimi nga prokurorja E.Cufi.</p> <p>Bashkëlidhur kërkesë padia dhe kresa e Prokurorisë së Shkallës së Parë Shkodër.</p>		
1046/3	02.07.2021	Delegim kerkese nga MK lidhet me kerkesen Nr.1046/2 Prot.	02.07.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : Pas ankesës verbale nga qytetari Z.B Bekteshi me dt.26.05.2021, specialistët e DRTK-Shkodër kanë inspektuar pasurinë kulturore, banesa e Ramiz Bekteshit, monument kulture i kategorisë së I-rë, shpallur me datë 08.01.1977.</p> <p>Motivi i ankesës ishte punime pa leje nga Z.B Kurtbegu, fqinji në perëndim të objektit. Nga inspektimi i kryer rezultoi se ndërhyrja që po bëhet nga komshiu është ngritja e një strukture metalike, profilet të së cilës janë në afërsi 2-3cm nga fasada e pasme e objektit.</p> <p>Përafërsisht 1.5-2m kjo strukturë futet nën catinë e objektit, pasuri kulturore, përkatësisht në murin e jashtëm të dhomës nga e cila ka marr statusin objekti.</p>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

			<p>Gjithashtu gjatë inspektimit në banesën e Besnik Kurtbegut u konstatua se qytetari po sistemonte oborrin, përmes shtrimit të tij me cemento deri në murin e objektit pasuri kulturore.</p> <p>Inspektimi është kryer në prani të Policisë e cila ka asistuar të gjithë procesin e inspektimit, ndërsa Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit refuzoi hyrjen në banesë.</p> <p>Në vijim të shkresës me Nr.145/1 Prot., datë 26.05.2021 administruar dhe protokolluar nga DRTK-Shkodër me anë të së cilës institucioni ynë ka kërkuar pezullimin e punimeve dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të punimeve të kryera nga Z.B Kurtbegu, përmes së cilës janë vënë në dijeni Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Shkodër, Prefekti i Qarkut Shkodër, Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.</p> <p>Z.Kurtbegu i është drejtuar institucionit tonë me anë të nje ankese “Saktësim i konstatimeve të bëra nga specialistët e DRTK-Shkodër në pronën time me dt.26.05.2021”.</p> <p>DRTK-Shkodër me shkresën nr.145/3, datë 03.06.2021 ku qytetari i është thënë se DRTK-Shkodër gjatë inspektimit ka evidentuar punime të realizuar nga ana e tij.</p> <p>Gjithashtu i është bërë me dije se DRTK-Shkodër është institucion i cili ushtron detyrën në mbrojtjen e pasurive kulturore nën administrimin e saj dhe si e tillë DRTK-Shkodër shqyrton vetem situatat ku rrezikohen pasuritë kulturore.</p> <p>Gjithashtu DRTK-Shkodër e ka orientuar Z.Kurtbegu që për të bërë ndërhyrje në afërsi të kësaj pasurie kulturore duhet të hartohet një projekt dhe të përcillet për mendim me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pranë institucionit tonë.</p> <p>Pranë institucionit tonë është administruar shkresa me nr.148/2 prot., datë 03.06.2021 protokolluar nga DRTK-Shkodër me nr 145/5, datë 08.06.2021 e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, nga ku i kërkohet IMT, zbatim i përgjegjësive dhe detyrave, marrjen e masave të nevojshme për strukturën metalike në fjalë si dhe të përcillet informacioni i plotë dhe i detajuar pranë IKMT-së .</p> <p>Shkresa e DRTK-Shkodër me nr.145/1, datë 26.05.2021 për pezullim punimesh dhe kthim në gjendjen e mëparshme nuk është zbatuar nga Z.Kurtbegu.</p> <p>Gjithashtu ju informojmë se Z.Kurtbegu ka ngritur një kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me objekt paligjshmërinë e shkresës me nr 145/1 prot, datë 26.05.2021 të DRTK-Shkodër, paligjshmërinë e shkresës nr 148 prot, datë 03.06.2021 të IKMT-Drejtoria Rajonale Shkodër, Pezullimin e veprimeve nga ana e tyre deri sa të zgjidhet gjyqësisht kjo çështje.</p> <p>Seanca e parë për masën e sigurimit të padisë është realizuar me datë 29.06.2021 nga ku Gjykata rrëzoi kërkesën për masën e sigurimit të padisë, si të pabazuar në ligj dhe prova.</p> <p>Gjithashtu Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër me anë të shkresës nr.22/6 (XH.Z), të datës 22.06.2021, administruar nga DRTK-Shkodër me nr.182.3 prot, datë 22.06.2021, ka komunikuar se në lidhje me shtetasin B.Kurtbegu</p>		
--	--	--	---	--	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				është rregjistruar kallëzimi 616.21 dhe ndodhet në fazë vlerësimi nga prokurorja E.Cufi. Bashkëlidhur kërkesë padia dhe kresa e Prokurorisë së Shkallës së Parë Shkodër.		
1119	25.06.2021	Kerkese per rishikim te projektit/vendimit te baneses ne lagjen "Gorice".	13.07.2021	Në vijim të ankesës së ardhur nga ankuesja L. Xhimitiku (numri i ceshajes 357671 në Platformën e bashkëqeverisjes), kërkesë e cila ka ardhur në rugë shkreore edhe në IKTK administruar me nr.1119 datë 25.06.2021, ju bëjmë me dije se : -KKTKM me vendimin nr.291 datë 08.06.2021 ka vendosur mbi mosvijimin e procedurës për legalizimin e objektit me vendndodhje në lagjen Goricë, Berat. -Me emailin e datës 02.07.2021, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës, i është Drejtuar DRTK-Berat me kërkesën për hartimin e një projekti me përshtatje me ndërhyrjet minimale të cilat të jenë në përputhje me projektin e miratuar në lagjen "Goricë" nga FSHZH dhe të paraqitet për gjykim dhe miratim në KKTKM. -Me shkresën nr.3332/1 prot., datë 05.07.2021 dhe administruar në IKTK me nr.1119/1 datë 06.07.2021, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës i drejtohet DRTK-Berat dhe IKTK me kërkesën për marrjen e masave për hartimin e një projekti, variant të përshtatjes së ndërtesës në përputhje me projektin e hartuar në lagjen "Goricë" nga FSHZH dhe projekti të përcillet për gjykim dhe miratim në KKTKM.	E plote	JO
1119/1	06.07.2021	Kerkese per bashkepunim deleguar nga MK	13.07.2021	Në vijim të ankesës së ardhur nga ankuesja L. Xhimitiku (numri i ceshajes 357671 në Platformën e bashkëqeverisjes), kërkesë e cila ka ardhur në rugë shkreore edhe në IKTK administruar me nr.1119 datë 25.06.2021, ju bëjmë me dije se : -KKTKM me vendimin nr.291 datë 08.06.2021 ka vendosur mbi mosvijimin e procedurës për legalizimin e objektit me vendndodhje në lagjen Goricë, Berat. -Me emailin e datës 02.07.2021, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës, i është Drejtuar DRTK-Berat me kërkesën për hartimin e një projekti me përshtatje me ndërhyrjet minimale të cilat të jenë në përputhje me projektin e miratuar në lagjen "Goricë" nga FSHZH dhe të paraqitet për gjykim dhe miratim në KKTKM. -Me shkresën nr.3332/1 prot., datë 05.07.2021 dhe administruar në IKTK me nr.1119/1 datë 06.07.2021, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës i drejtohet DRTK-Berat dhe IKTK me kërkesën për marrjen e masave për hartimin e një projekti, variant të përshtatjes së ndërtesës në përputhje me projektin e hartuar në lagjen "Goricë" nga FSHZH dhe projekti të përcillet për gjykim dhe miratim në KKTKM.	E plote	JO
1154	05.07.2021	Kerkese per informacion ]per objektin me kod Nr.3282 banese sheterore.	15.07.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të plotë arkivor për objektin me kod Nr. 3282 "Banesa shtetërore (ish e Alush Takës), bashkia Konispol, të njëhësuar me origjinalin dhe në format elektronik (CD), si më poshtë: - Dokumentacioni i vjetër grafik; - Foto historike; - Relacion teknik si dhe ndërhyrjet restauruese të viteve 1982-1983; - Dokumenti "Vënie në mbrojtje e monumenteve" për klasifikimin "monument kulture" nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Drejtoria e Kulturës me Nr. 266/ I, Prot., datë 16.02.1979. Bashkëlidhur dhe materialet e arkivit me kod arkivi Nr. -.	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<a href="https://we.tl/t-cbg00eoZ0A">https://we.tl/t-cbg00eoZ0A</a> Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur të citohet burimi nga është marrë - Arkivi Teknik i IKTK.		
1165	06.07.2021	Kerkese per informacion dhe nderpritje e cdo veprimi i cili synohet te ndermerret me pronen e saj.	09.07.2021	Ne vijim te kerkese Suaj, ju bejme me dije se : sipas dokumentacionit te pronesise me Nr.4/268, Z.K. 8502 dhe verifikimin e pozicionit te objektit, rezulton se banesa gezon statusin pasuri kulturore, monument kulture i kategorise se II-te me kod II-099, sipas Urdhrit te Ministrit Nr.148, date 17.04.2015. Bazuar ne shkresen Tuaj me Nr.208 Prot., date 08.06.2021, drejtuar Z. Petra Sinjari, ju informoni se jeni ne proces hartimi te nje projekti per punime mirembajtjeje per murin ndares mes oborreve, me kerkese te Znj. Greta Kajana. Ne vijim, kerkohet te beni nje verifikim ne terren mbi pretendimet e Znj. Eriselda Gjoci dhe percillni prane Institutit Kombetar te Trashegimise Kulturore nje relacion te detajuar. Bashkelidhur Ju dergojme kopje te kerkeses se administruar ne IKTK, se bashku me kopjen e dokumentit te pronesise ne menyre qe te behet verifikimi ne lidhje me kerkesat e qytetarit.	E plote	JO
1189	09.07.2021	Kerkese per informacion mbi datat e fillimit dhe mbarimit te projekteve .	22.07.2021	Në vijim të kërkesës suaj, mbi kërkesën për informacion lidhur me datën e fillimit dhe mbarimit të kontratave të projekteve, Ju paraqesim informacionin si më poshtë: Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në 4 objekte kulturi pasuri kulturore". Kontrata është lidhur me datë 09.10.2020 dhe ka përfunduar më datë 21.12.2020; Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në 8 objekte pasuri kulturore dhe muze në Bashkinë Durrës". Kontrata është lidhur më datë 09.10.2020 dhe ka përfunduar më datë 22.12.2020; Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në 5 objekte pasuri kulturore". Kontrata është lidhur më datë 09.10.2020 dhe ka përfunduar më datë 22.12.2020; Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 9 objekteve institucione publike në Bashkinë Tiranë". Kontrata është lidhur më datë 09.10.2020 dhe ka përfunduar më datë 28.12.2020; Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 12 objekteve në Bashkinë Tiranë, Krujë, Lezhë, Kavajë, Mirëditë". Kontrata është lidhur më datë 09.10.2020 dhe ka përfunduar më datë 28.12.2020; Hartimi i Raporteve të Vëzhgimit Arkeologjik në 24 Zonat e Reja të Zhvillimit. Kontrata është lidhur më datë 29.09.2020 dhe ka përfunduar më datë 02.12.2020; Kryerja dhe hartimi i raporteve të sondazheve arkeologjike në 2 zonat e reja ti Zhvillimit. Kontrata është lidhur më datë 29.09.2020 dhe ka përfunduar më datë 09.12.2020; Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja ti Zhvillimit. Nuk është zhvilluar ende proqedura e prokurimit publik;	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>Restaurim i Kishës së "Shën e Premtes në fshatin Vlash", Faza II, Gjinar, Elbasan. Kontrata është lidhur më datë 07.10.2020 dhe ka përfunduar më datë 14.12.2020;</p> <p>Restaurim i Kishës së "Shen Ilia Stegopull". Kontrata është lidhur më datë 07.10.2020 dhe ka përfunduar më datë 17.12.2020;</p> <p>Realizim i punimeve të konservimit dhe drenazhimit në Portin me Kulla dhe Nimfeu, Qyteti Antik Butrint (parafinancim IPA). Kontrata është lidhur më datë 03.11.2020 dhe ka përfunduar më datë 21.12.2020;</p> <p>TVSH projektin IPA "3D-JMP-ACT". Krijimi i një Laboratori ri 3D në IMK". Nuk ka kontratë.</p> <p>Hartim "Plani i konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruse në objektin: "2 (dy) objekte banimi brenda Kalasë së Krujës, brenda Zonës Arkeologjike "A" të qytetit të Krujës vlerësuar me nivel dëmi DS4 (Nr. 54 dhe Nr. 66)". Kontrata është lidhur më datë 06.05.2021 dhe ka përfunduar më datë 26.05.2021 ;</p> <p>Hartim "Plani i konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruse në objektin: Muri i Kalasë Durrës (pa kullën C por me Kullën Veneciane Durrës)". Kontrata është lidhur më datë 06.05.2021 dhe ka përfunduar më datë 26.05.2021;</p> <p>Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit. Nuk është zhvilluar ende proqedura e prokurimit publik.</p>		
1197/2	22.07.2021	Kerkese per rishikim projektit te restaurimit te hartuar nga DRTK percjelle nga MK.	23.07.2021	Në vijim të kërkesës Suaj me Nr. 3580 Prot, datë 12.07.2021, përcjellë nga Ministria e Kulturës dhe administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.1179/2 Prot, datë 22.07.2021, Ju bëjmë me dije se: Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë, është në proces rishqyrtimi të projektit të restaurimit të hartuar nga specialistët e kësaj drejtorie.	E plote	JO
1226	15.07.2021	Kerkese per heqje statusi Monument Kulture tip vile.	25.07.2021	Në përgjigje të kërkesave Tuaja, , lidhur me kërkesën për verifikimin e interesit kulturor për objektin pasuri kulturore në qytetin e Tiranës, Ju bëjmë me dije se: Në vijim të kërkesës Suaj, administruar në IKTK me Nr. 386 Prot., datë 19.03.2021, për rishikim statusi të objekti pasuri kulturore (II-212), me Vendim të KKTKM Nr. 198, datë 06.04.2021 është vendosur mosmiratimi i kërkesës për objektin e sipërcituar. Në lidhje me kërkesat e përsëritura për të këtë çështje, të përmendura më sipër, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë me shkresë Nr. 393 Prot., datë 09.07.2021, ka përcjellë pranë IKTK relacionin për verifikimin në terren të gjendjes së objektit pasuri kulturore, monument kulturore i kategorisë së II-të (II-212) dhe konstaton se gjendja e objektit paraqitet problematike. Bazuar në shkresën për mbështetje drejtuar nga ana Juaj, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, bashkëlidhur kësaj kërkesë, duke qenë se objekti paraqitet në gjendje të degraduar nga tërmeti i Nëntorit 2019, lutemi të përcillni pranë IKTK përgjigjen e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me qëllim arritjen e një konkluzioni.	E plote	JO
1228	15.07.2021	Kerkese per vleresim te gjendjes se objektit Monument Kulture kategoria e I-re te demtuar nga termeti i dates 26 nentor 2019.	21.07.2021	Në vijim të kërkesës, jemi informuar nëpërmjet një relacioni përshkrimor mbi problematikat e gjendjes ekzistuese të 1 (një) objekti pasuri kulturore, i cili ka	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>pësuar dëmtime si pasojë e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019. Bazuar në listën e pasurive kulturore, është:</p> <p>_ Banesa e Shaqir (Elmaz) Dëzhgiut në fshatin Gur i Bardhë, Xibër, Klos, Dibër</p> <p>(monument kulture i kategorisë Së I-rë)</p> <p>Për sa më sipër, kërkohet nga ana Juaj një vlerësim në terren i gjendjes së konservimit të këtij objekti dhe të merren masa për hartimin e projektit të ndërhyrjeve të nevojshme në të.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni një kopje të kërkesës dhe relacionit përshkrimor të kësaj banese.</p>		
1247	19.07.2021	Kerkese per materiale nga arkiva .	27.07.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje të materialit arkivor në format elektronik (CD), për objektin "Banesa e Netajve (Porta) " në fshatin Saraqinisht, Gjirokastër si më poshtë:</p> <p>-Foto historike; -Dokumentacion grafik; -Relacion teknik i vitit 1984.</p> <p>Bashkëlidhur dhe materialet e arkivit me kod arkivi Nr. - <a href="https://we.tl/t-goc8pbMrGY">https://we.tl/t-goc8pbMrGY</a></p> <p>Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë - Arkivi Teknik i IKTK.</p>	E plote	JO
1252	21.07.2021	Kerkese per informacion per Kishen e Shen Gjergjit ne Golloborde.	29.07.2021	<p>Në vijim të email-it të dërguar nga shoqata Maqedonase me Nr. 839/2021, date 21.07.2021, administruar ne Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 1252 Prot., datë 21.07.2021, me kërkesën për informacion për shpalljen monument kulture të kishës së Shën Gjergjit (Crkva Sveti Gjeorgjia), ne fshatin Vërnice, zona e Gollobordës, Ju bëjmë me dije se:</p> <p>Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", Neni 58, kërkojmë nga ana Juaj marrjen e masave për realizimin e verifikimit të interesit kulturor për objektin "Kisha e Shën Gjergjit (Crkva Sveti Gjeorgjia), ne fshatin Vërnice, zona e Gollobordës.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni kërkesën e përcjellë nga ana e shoqatës Maqedonase.</p>	Deleguar DRTK Tiranë	JO
1253	21.07.2021	Kerkese per futje ne listen e Monumenteve te Kishes se Palases ne Himare.	29.07.2021	<p>Në vijim te email-it të dërguar nga Z. Th. Duka, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 1253, date 21.07.2021, me kërkesën Për shpallje monument kulture të objektit "Kisha e Palasës", Himarë, Ju bëjmë me dije se : Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", Neni 58, kërkojmë nga ana Juaj marrjen e masave Për realizimin e verifikimit të interesit kulturor për objektin "Kisha e Palasës", Himarë.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni kërkesën e përcjellë nga Z. Th. Duka.</p>	Deleguar DRTK Vlorë	JO
1262	21.07.2021	Kerkese per informacion/materiale nga arkiva per Kishen e Shen Nikolla, Golloborde.	23.07.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj , Ju bëjmë me dije si vijon: Objekti "Kisha e Shën Nikollës (Crkva Sveti. Nikola), në fshatin Ostren i Vogël, zona e Gollobordës nuk ka status "monument kulture".</p> <p>Në arkivin teknik të IKTK nuk disponojmë asnjë dokumentacion grafik, përshkrimor apo fotografik për këtë kishë.</p>	E plote	JO



## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

1272	22.07.2021	Kerkese per informacion deleguar nga MK	05.08.2021	<p>Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije se:                  Bazuar në informacionin e depozituar nga Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, në vitin 2020 nuk kemi patur objekte të dëmtuara në mënyrë të pakthyeshme.                  Ndërhyrje të pa autorizuar janë raportur në:                  Kalanë e Gradecit, Kolonjë;                  Kalanë e Bellovodës, Korçë;                  Kalanë e Bellovës, Dibër;                  Parkun Arkeologjik të Amantias (ndërhyrje klandestine në Nekropolin Antik);                  ■ Parkun Arkeologjik të Orikut (ndërhyrje klandestine në Nekropolin Antik).</p> <p>Informacionin lidhur me Buxhetin e shtetit të akorduar për Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për restaurimin e monumenteve e gjeni në faqen zyrtare të IKTK: <a href="http://www.iktk.gov.al">www.iktk.gov.al</a>.</p> <p>Informacioni për investimet nga donatorët në objektet pasuri kulturore administrohet nga Ministria e Kulturës. Investimet në përgjithësi janë në objektet pasuri kulturore të dëmtuara nga tërmeti, si edhe objekte të tjera pasuri kulturore.</p> <p>Objektet pasuri kulturore, të cilat janë në proces restaurimi apo në përfundim të procesit të restaurimit janë:                  Kisha e Shën Premtes, Lukovë;                  Kulla C në Kalanë e Durrësit;                  Teqja e Dollmës;                  Kulla e Sahatit, Krujë;                  Rrjeti i muzeve në Gjirokastrë;                  Kisha e Manastirit të Rubikut; ■ Kulla e Prezës.</p> <p>Nëpërmjet programit EU4Culture do të realizohen investimet në objekte pasuri kulturore, për të cilat janë hartuar projektet e restaurimit. Këto investime do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së programit.                  Bazuar në ligjin Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 143, pika 2, shpenzimet për hulumtimet me karakter parandalues, të cilat realizohen nga IKTK ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike, mbulohen nga investitori dhe për to nuk ka një buxhet specifik të miratuar. Financimi dhe vlera e operacionit të gërmimit arkeologjik me karakter parandalues, përcaktohen rast pas rasti, në varësi të sipërfaqes dhe intensitetit të gjetjeve arkeologjike që duhet të gërmohen.                  Informacionin lidhur me zonat me potencial arkeologjik e gjeni në faqen zyrtare të IKTK: <a href="http://www.iktk.gov.al">www.iktk.gov.al</a>.</p> <p>Në përputhje me ligjin Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", si dhe aktet nënligjore, pasuritë kulturore dhe sitet arkeologjike janë në administrim të DRTK — ve dhe NJAKPA, të cilat sipas fushës së tyre të kompetencës, kujdesen dhe administrojnë territorin nën juridiksion, pasuritë kulturore, sitet arkeologjike dhe/ose parqet arkeologjike.</p>	E plote	JO
1312	29.07.2021	Kerkese per vertetim per listen e projekteve ku ka qene autor/bashkautor ne mbikqyrje/kolaudim .	30.09.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, administruar në Sekretarinë Teknike në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 1312, date</p>		

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				28.07.2021, si dhe ne vijim te konfrmimit Tuaj me e-mail me date 27.09.2021, Ju bejme me dije se: Ju keni qene pjese e grupit te projektimit ne projektet e miratuara ne KKRIKTKM, si me poshte:		
1320	29.07.2021	Kerkese per vertetim per listen e projekteve ku ka qene autor/bashkautor ne mbikqyrje/kolaudim .	30.09.2021	Ne pergjigje tekerkeses Suaj adminstruar ne Sekretarine Teknike ne Institutin Kombetar te Trashegimise Kulturore, me Nr. 1320 Prot., date 29.07.2021, si dhe ne vijim te konfmimit Tuaj me e-mail me date 23.09.2021, vertetojme se: Znj. Isida Celiku ka qene punonjes si specialiste ne sektorine Qendrave Historike Arkitektura e Tradites dhe Peizazhit, Instituti Kombetar iTrashegimise Kulturore (Ish-IMK), gjate periudhes kohere 20.08.2015 - 18.02.2020.		
1330	02.08.2021	Kerkese per informacion per banesen e Toptaneve.	06.08.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit përshkrimor dhe fotografik për objektin me kod Nr. 1807 ”Banesa e familjes së Toptanasve”, në Tiranë: Dokumentacion teknik (Planimetri, prerje, pamje, detaje); Dokumentacion fotografik; Dokumentacion përshkrimor.	E plote	JO
1334/1	04.08.2021	Delegim kerkese per informacion nga MK	05.08.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, lidhur me shqetësimin e shprehur për objektin pasuri kulturore "Bazilika paleokristiane jashtë mureve të Scampis, Elbasan ", Ju informojmë se në përputhje me detyrimin ligjor që Ministria e Kulturës ka për këtë monument, me qëllim mirëmbajtjen, restaurimin dhe gërmimin e tij, ka miratuar projektet si vijon: -"Bazilika paleokristiane jashtë mureve të Scampis, Elbasan", viti 2018; -"Ndërhyrje konservues/restauruese në pikturën murale të bazilikës paleokristiane, Elbasan", viti 2018; -"Sustainable and integrated development of cultural and historical heritage Albania", viti 2012; Projekti kërkimor — shkencor "Lagja Romake-Bizantine jashtë mureve te castrum Scampis (Elbasan), Bazilika Paleokristiane jashtë mureve" .	E plote	JO
1337	02.08.2021	Delegim kerkese per informacion nga MK	06.08.2021	Në vijim të kërkesave Suaja , Ju bëjmë me dije se :  1. Në datat 16-31 Korrik 2021 është zhvilluar Sesioni i 44-rt i zgjeruar i Komitetit të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në format virtual. Në punimet e sesionit, ishte në rend të pikës 7B, mbi “Gjendjen e Ruajtjes së pasurive të regjistruara Listën e Trashëgimisë Botërore”, projekt vendimi mbi raportin e gjendjes së konservimit të “Qendrave Historike Berat-Gjirokastrë”. Nga ana e Qendrës së Trashëgimisë Botërore i është përcjellë nëpërmjet Misionit të përhershëm të shtetit shqiptar pranë UNESCO-s, teksti i projekt vendimit që i është paraqitur sesionit lidhur me pasurinë “Qendrat Historike të Beratit dhe Gjirokastrës”. Në mënyrë të përmbledhur, Komiteti vlerëson “miratimin e Ligjit "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeumet" për të forcuar dhe përmirësuar ruajtjen dhe administrimin e (Berat-Gjirokastrë), restaurimin dhe mirëmbajtjen e ndërmarrë gjatë vitit 2019 dhe 2020, si dhe zbatimin e treguesve të monitorimit dhe krijimin e një sistemi për miratimet e ndërtimit në menaxhimin e pronës dhe zonave të saj mbrojtëse”; Po ashtu, Komiteti “mirëpret dorëzimin e propozimeve të ndryshme të projektit të Komponentit të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban (PIUTD), përveç rrugës by-pass për Gjirokastrën dhe, duke theksuar se	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

			<p>projekti PIUTD ka si qëllim kryesor zhvillimin e turizmit, i kërkon Shtetit Palë që:</p> <p>a) të marrë parasysh komentet dhe rekomandimet e ofruara nga ICOMOS për të përmirësuar projektet e paraqitura në Anekset 3, 4, 5, 8 dhe 9 të SoC, për zhvillimin e mëtejshëm të propozimeve të projektit dhe para zbatimit të tyre”</p> <p>b) rishikimin e mëtejshëm nga Organet Këshillimore të projekteve të paraqitura në Anekset 6 dhe 7 të raportit për gjendjen e konservimit (SoC) përpara se të marrin ndonjë vendim tjetër për zbatimin e tyre;</p> <p>c) të diversifikojë planet e të zhvillimit, për të stimuluar një bazë të gjerë elastike ekonomike për të ardhmen e pronës”;</p> <p>d) Në pikën 5 të projekt vendimit, Komiteti “përsërit kërkesën që Plani i Menaxhimit të Integruar të plotësohet menjëherë duke marrë parasysh kërkesat e mëparshme të Komitetit dhe t'i paraqitet QBT për rishikim nga Organet Këshillimore përpara zbatimit të tij”;</p> <p>e) Në pikën 6, duke iu referuar projektit të by-pass-it në Gjirokastrë, i cili sipas informacioneve të marra nga palë të treta është në zbatim e sipër, Komiteti “...kërkon urgjentisht që Shteti Palë të ndalojë ndërtimin e by-pass-it derisa një mision Monitorimi Reaktiv të vizitohet pasurinë për të vlerësuar nëse projekti ka shkakuar ose do të shkaktojë ndonjë dëm në vlerës të veçantë universale (OUV)”.</p> <p>Për këtë, siç është praktikë e gjithëshme, Komiteti i kërkon vendit tonë që “të ftojë një ekip të përbashkët të QBT / ICOMOS / IÇROM për një Mision Monitorimi Reaktiv në Berat- Gjirokastrë për të vlerësuar progresin e bërë në gjendjen e ruajtjes së tërë pasurisë”.</p> <p>Raporti i ardhshëm për Berat-Gjirokastrë do të duhet të dorëzohet deri më 1 shkurt 2022, për shqyrtim nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore në sesionin e tij të 45-të.</p> <p>Sa më sipër, ky projekt vendim u miratua në datë 22 Korrik 2021, nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore pa diskutim. Aktualisht pritet zbardhja e këtij vendimi i cili, pas miratimit, ende nuk është përcjellë zyrtarisht.</p> <p>2.Si pjesë e shteteve palë të Konventës së Trashëgimisë Botërore, edhe shteti ynë ka siguruar zbatimin e kësaj Konvente si dhe është i prirur të marrë parasysh rekomandimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore. Në këtë kuadër, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore në cilësinë e pikës fokale për trashëgiminë kulturore botërore, do të përcjellë vendimin zyrtar të Komitetit të Trashëgimisë Botërore pranë Bashkisë Gjirokastrë (investitor dhe hartues i projektit të By-passit) me kërkesë për të marrë masat në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të UNESCO-s për projektin e By-passit Gjirokastrë.</p> <p>3.Të gjitha raportet periodike të hartuara nga shteti palë mbi gjendjen e konservimit të pasurisë botërore Berat – Gjirokastrë janë të aksesueshme online në faqen web të Qendrës së Trashëgimisë Botërore:  <a href="http://whc.unesco.org/en/list/569/documents/">http://whc.unesco.org/en/list/569/documents/</a> Projekti i By-passit Gjirokastrë përmendet në raportin e vitit 2020 si dhe ka qenë objekt korrespondencave shkresore midis Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Qendrës e Trashëgimisë Botërore (korrespondenca të realizuara nëpërmjet Misionit të përhershëm të Shqipërisë pranë UNESCO-s),</p>		
--	--	--	---	--	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkresa e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Nr. 118 Prot., datë 20.01.2021, drejtuar Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë pranë UNESCO-s, mbi përcjelljen e projektit të zbatimit për By-pass Gjirokastër, si dhe Vendimit Nr. 7, datë 15.1.2021 të KTKM-së, për shqyrtim nga organet këshillimore të UNESCO-s, bazuar në paragrafin 174 të udhëzuesit operacional të Konventës së Trashëgimisë Botërore.</li> <li>- Shkresa e Qendrës së Trashëgimisë Botërore (QTB) ref. CLT/WHC/EUR/21/13087, datë 25.01.2021, drejtuar Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë pranë UNESCO-s, ku konfirmohet marrja nga ana e UNESCOs e projektit të Bypassit Gjirokastër dhe përcjellja e tij për mendim pranë organeve këshillimore (ICOMOS).</li> <li>- Shkresa e QTB-së ref. CLT/WHC/EUR/21/13216, datë 16.03.2021 (në IKTK me Nr.459 Prot., datë 18.03.2021) ku ndër të tjera dërgohet nga QTB informacion nga palë të treta në lidhje me zhvillimin e punimeve për projektin e Bypass Gjirokastër.</li> </ul> <p>Nëpërmjet kësaj shkrse QTB kërkon verifikimin e përmbajtjes dhe informacion zyrtar nga shteti mbi mënyrën se si dhe në ç'masë lidhet projekti i Bypassit me projektet e tjera zhvillimore në të gjithë pasurinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkresa e QTB-së Ref.: CLT/WHC/EUR/21/13279, datë 22.04.2021, nëpërmjet së cilës dërgohen rekomandimet teknike të ICOMOS-it dhe ku citohet se QTB nuk ka ofruar rekomandime për projektet zhvillimore të paraqitura në raport dhe projektin e Bypassit të përcjellë në janar 2021, në pritje të përgjigjes nga Shteti palë për shkresën e datës 16 mars 2021. - Shkresa e IKTK-së Nr. 792/1 datë 12.05.2021 ku jepet informacioni i kërkuar nga QTB në shkresën e datës 16.03.2021.</li> <li>- Shkresa e QTB-së Ref.: CLT/WHC/EUR/21/13329, datë 31.05.2021 ku konfirmohet marrja e informacionit shtesë nga shteti palë (datë 12.05.2021) të kërkuar nga QTB nëdatë 16.03.2021 dhe në datë 22.04.2021.</li> <li>- Shkresa e IKTK-së Nr. 792/3 datë 02.06.2021, drejtuar Ambasadorit të Shqipërisë pranë UNESCOs e cila shpjegon edhe njëherë faktin se shteti palë i ka përcjellë UNESCOs që në janar 2021 projektin e Bypass-it dhe Vendimin e miratimit të tij dhe se ende është në pritje të rekomandimeve të UNESCOs.</li> </ul>		
1341	03.08.2021	Kerkese per informacion lidhur me ndertimet ngjitur dyqanit ne Qafen e Pazarit, Gjirokaster .	06.08.2021	<p>Në vijim të kërkesës së Z. V. Kokalari, jemi informuar për problematikën në disa objekte në pronësi të tij, me adresë "Qafë e Pazarit", Rr. "Koqollari", Gjirokastër.</p> <p>Përsa më sipër, kërkohet nga ana Juaj një vlerësim në terren i gjendjes së objektit dhe hartimi i një relacioni të detajuar, i cili do të përcillet pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni kopje të kërkesës së Z. V. Kokalari.</p>	Deleguar për kompetence, DRTK Gjirokastër.	JO
1348	04.08.2021	Delegim ankese nga MK.	04.08.2021	<p>Ne lidhje me ceshtjen, Ju bejme me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Me date 26.05.2021 eshte percjelle ceshtja nr 348174 delegim ankese e Znj. O. Muçaj, administruar ne IKTK me Nr. 921 prot., date 26.05.2021</li> <li>2. Me Nr. 921/1 Prot., date 31.05.2021 eshte pecjelle kthim pergjigje ku dergohet projekti i miratuar me Vendim Nr. 141, date 21.3.2018 "Riparime ne godine banimi ekzistuese 2 kate ne Qeparo, ne pronesi te O. Muçaj".</li> </ol>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>3. Me date 02.07.2021 është përcjelle vijimi i ankeses Nr. 348174 delegim ankese e Znj. O. Muçaj, ku kërkohej informacion rreth firmes zbatuese te punimeve ne objektin e miratuar me Vendim nr. 141, date 21.3.2018.</p> <p>4. Me date 05.07.2021 është kthyer pergjigje ne lidhje me ankesen Nr. 348174 delegim ankese e Znj. O. Muçaj, ku informojme se:</p> <p><i>- Me shkrесе Nr.921/1 Prot., date 31.05.2021, IKTK ka kthyer pergjigje per ceshtjen Nr. [348174] Delegim ankese - Ankese Ministria – O. Muçaj - 2021-05-26, ku ka përcjelle projektin e miratuar per banesen ne pronesi te Znj. O. Muçaj ne fshatin Qeparo;</i></p> <p><i>- Projekti është miratuar me Vendim te Keshillit Kombetar te Restaurimeve Nr.141, date 21.03.2018(Vendimi bashkelidhur)</i></p> <p><i>- Prane Arkivit te Institutit Kombetar te Trasbegimise Kulturore nuk rezulton informacion shtese ne lidhje me zhatimin e punimeve ne kete objekt.</i></p> <p>Po Ju bashkengjisim serish dokumentacionin e përcjelle sipas kronologjise se sipercituar. I vetmi informacion qe administrojme.</p>		
1349	04.08.2021	Delegim ankese nga MK.	09.08.2021	<p>Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije se: Me datë 06.04.2021 pranë Sportelit Unik të Sekretarisë Teknike është paraqitur një projekt restaurimi i hartuar nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë, për objektin pasuri kulturore, monument kulture kategoria e II-të, me emërtim "Vila Polena" në Korçë. Pas shqyrtimit në Këshillin Teknik, me anë të shkresës Nr.506/1 Prot., datë 19.04.2021, projekti është kthyer për plotësim. kërkuar rishikimin e statusit të kësaj pasurie kulturore, monument kulture kategoria e II-të, shpallur me vendim NT. 582, date 25.09.2007 nga M.T.K.R.S. Kjo kërkesë është përcjellë edhe nga Ministria e Kulturës me shkresë Nr.1197 Prot., datë 23.07.2021. Me shkresë Nr. 1197/2 Prot., datë 23.07.2021, IKTK i ka përcjellë DRTK Korçë kërkesat e mësipërme me qëllim verifikimin në terren të së konsewimit të pasurisë kulturore të sipërcituar dhe vlerësimin e saj. Me shkresë Nr.1197/3, datë 23.07.2021, DRTK Korçë ka përcjellë relacionin mbi inspektimin në terren të objektit, kryer nga specialistët e kësaj drejtorie. Në vijim të shkresës Nr. 3580 Prot., datë 12.07.2021, përcjellë nga Ministria e Kulturës dhe administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 1179/2 Prot, datë 22.07.2021, z.Ylli Polena kërkon hartimin e një projekti restaurimi për objektin pasuri kulturore, monument kulture kategoria e II-të, me emërtim "Vila Polena" në Korçë. Me anë të shkresës Nr. 1197/4 Prot., datë 23.07.2021, IKTK informon z.Ylli Polena që DRTK Korçë është në proces rishqyrtimi të projektit të restaurimit të hartuar.</p>	E plote	JO
1350	04.08.2021	Delegim ankese nga MK.	09.08.2021	<p>Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije se: Në mbështetje të Ligjit Nr.28/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", në KKTkM janë shqyrtuar dy aplikime për "Rikonstruksion / rindërtim banese ekzistuese I kat, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike "A " të qytetit të Durrësit" me aplikues Z. Andi Rizja dhe Znj. Fiona Rizja, të cilat janë miratuar me Vendimet si më poshtë vijon:</p>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				Me Vendim të KTKM Nr. 396, datë 18.11.2020, është miratuar projekti 'Rikonstruksion / rindërtim banese ekzistuese I kat, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike "A " të qytetit të Durrësit", me aplikues Z. Andi Rizja. Me Vendim Nr. 442, datë 28.07.2021, është miratuar projekti "Ncbyshim projekti të miratuar: Rikonstruksion (rindërtim) i banesës ekzistuese I-kat me çati" brenda kufirit të Zonës Arkeologjike A " të qytetit të Durrësit", me aplikues znj. Fiona Rizja.		
1353	04.08.2021	Kerkese per informacion per nderhyrjen ne fshatin Dhërmi .	18.08.2021	Në përgjigje të kërkesës Suaj, në lidhje me informacionin e kërkuar për ndërhyrje në fshatin Dhërmi, Ju bëjmë dije se: Prona me Nr. Pasurie Nr. 8, Zona Kadastrale Nr. 1481, me vendndodhje në Dhërmi, ndodhet brenda kufirit të qendrës historike të fshatit Dhërmi, miratuar me Vendim Nr. 25, datë 20.01.2016 “Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Dhërmi dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj dhe zonës së mbrojtur përreth”. Sa më sipër, ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike përcaktohen në Nenin 4 të Vendimit të sipërcituar. Në zbatim të pikës 3, të Nenit 4 të Vendimit Nr. 25, date 20.01.2016, projektet e rikonstruksioneve në këtë zone duhet të hartohet nga IKTK, DRTK Vlorë apo subjekte të licencuara në fushën e restaurimit për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Teknik në IKTK dhe Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale në Ministrinë Kulturës. Dokumentacioni i nevojshëm për projektin, që kërkohet gjatë fazave të aplikimit online, në mënyrë të përmbledhur janë si në vijim: 1. Projektet teknike dhe relacionet përkatëse, në formatin pdf dhe të nënshkruara elektronikisht nga peson i licensuar ne restaurim për këtë kategori ndërhyrjesh: (Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhurnuar të hartës së parcelës; Vendndodhja me koordinata gjeografike; Ortofoto; Specifikime Teknike); 2. Grafiku i Punimeve; 3. Preventiv; 4. Prezantim Projekti në powerpoint; 5. Projekti i plotë në format të editueshëm (AutoCAD, Revit, Archicad, etj). Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, e ndryshuar dhe Urdhërit të Ministrisë Nr. 729, datë 18.12.2019, aplikimi për leje për ndërhyrje në pasuri kulturore materiale kryhet nëpërmjet sistemit E-Albania duke aksesuar linkun: <a href="https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702">https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702</a> .	E plote	JO
1359	05.08.2021	Kerkese per informacion ne Bashkine Gjirokaster.	06.08.2021	Në vijim të kërkesës Suaj më datë 05.08.2021, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 1359 Prot., datë 05.08.2021, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit përshkrimor dhe fotografik Për objektin me kod Nr. 3934 "Kroi i çetës së mesme", në fshatin Dhoksat, Gjirokastër: Dokumentacion i shkruar Dokumentacion grafik. Ju bëjmë me dije se Për këtë Objekt nuk disponojmë dokumentacion fotografik.	E plote	JO
1368	06.08.2021	Kerkese per informacion mbi autoreesine ose bashkautoreesine ne projektet e zhvilluara nga IKTK.	06.08.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, sipas verifikimit të bërë në Arkivin Teknik, ju vërtetojmë autorësinë-bashkëautorësinë e znj. K. Papando në projektet e listuara më poshtë:	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>- "Rikonstruksion banese, Rr. Kostandin Gaçe, Korçë", në Qendrën Historike të Korçës, miratuar me vendim KKR Nr. 82, datë 12.05.2017;</p> <p>- "Projekt restaurimi i Bar dhe Restorant COLONIAL &amp; OSTERIA, Korgë", miratuar me vendim KKR Nr. 100, datë 12.05.2017;</p> <p>- "Rijetëzimi i Pazarit, punimet e brendshme dyqani 9/1, Blloku 24", Korgë, miratuar me vendim KKR Nr. 101, datë 12.05.2017;</p> <p>- "Rikonstruksion banese në rrugën e Durrësit, në pronësi të z. Bujar Kapexhiu", miratuar me vendim KKR Nr. 94, dt. 20.02.2018;</p> <p>- "Rikonstruksion qatie në Pallatet Agimi, Tiranë". miratuar me vendim KKR Nr. 93, date 20.02.2018;</p> <p>- "Rikonstruksion i banesës së Merita Gramatikut, në Bulevardin Zogu i I-rë, me nr. pasurie 6/341 Nr+I-I, Tiranë, miratuar me vendim KKR Nr. 138, datë 21.03.2018.</p>		
1372	09.08.2021	Kerkese per materiale nga arkiva , Kisha e Manastirit te Rubikut.	13.08.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur në link kopje të dokumentacionit përshkrimor dhe fotografik për objektin me kod Nr. 1293, "Kisha e Manastirit të Rubikut", në Rubik :</p> <p>Dokumentacion teknik; Dokumentacion fotografik; Dokumentacion përshkrimor.</p> <p>Bashkelidhur dhe materialet e arkivit me kod arkivi Nr. - <a href="http://we.tl/t-8cT9fK8NZf">we.tl/t-8cT9fK8NZf</a></p>	E plote	JO
1373 1373/1 1373/2	09.08.2021 16.08.2021 16.08.2021	Kerkese per vertetim per projektet ku ka marre pjese.	25.08.2021	<p>Ne vijim te kerkeses Suaj, në lidhje me projektet , vërtetojmë se: Znj. E. Bushi është pjesë e grupit të projektimit të projekteve të miratuara si më poshtë: :</p> <p>Projekt restaurimi "Shëtitorja e Apollonisë", Fier, (Vendim Qarkullues Nr.2, datë 02.05.2011);</p> <p>Projekt përshtatje ambientet e Ish Kinostudios "Shqipëria e Re". Projektimi i laboratorëve të konservimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, (Vendim Nr.7, datë.06.10.2011);</p> <p>Projekt rivitalizimi "Ish Banka e Shtetit Shkodër", (Vendim Nr. 21, datë 1 0,05.2013);</p> <p>Projekt restaurimi Hamami i Meçites, Gjirokastër, (Vendim Nr. 1 7, datë 10.05.2013);</p> <p>Projekt restaurimi i fasadave të Pazarit të Korçës, (Vendim Nr. 3, datë 13.02.2013);</p> <p>Projekt Restaurim Hamami i vjetër në kalanë e Krujës, (Vendim Nr. 17, datë 20.05.2013);</p> <p>Projekt "Shtëpia ku u ngrit flamuri në Korçë", (Vendim Qarkullues Nr. 22, datë 10.05.2012).</p> <p>Znj. E. Bushi është caktuar mbikqyrës ose kolaudator në projektet si më poshtë:</p> <p>"Rikonstruksion i laboratorëve të IMK-së dhe restaurimi i fasadës së godinës së IMKsë, Tiranë, viti 2012;</p> <p>"Ndërhyrje restauruese në orkestrën e teatrit të Hadrianopolit" në Sofratikë. Gjirokastër, viti 2012;</p>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				"Nderhyrjet restaurese dhe reabilituese të cilat do të kryen në Muzeun Arkeologjik të Apollonisë", viti 2012.		
1384	12.08.2021	Kerkese per informacion per Uren e Kamares .	25.08.2021	Ne vijim te kerkeses Suaj me date 12.08.2021, administruar ne Institutin Kombetare te Trashegimise Kulturore (NE vijim IKTK), me Nr.1384 Prot., date 12.08.2021, ne lidhje me kerkesen per informacion per " Uren e Kamares" ju njoftojme se: " Ura e Kamares" ne njesine administrative Polis, Bashkia Librazhd eshte shpallur Monument Kulture Kategoria e Pare, nga Ministria e Arsimit dhe Kultures ( Drejtoria e Kultures), me Vendim nr.6, date 15.01.1963. Ne mledhjen e Keshillit Kombetar te Trashegimise Kulturore Materiale (KKT KM), eshte miratuar projekti " Nderhyrje restauruese ne Uren e Kamarës", hartuar nga specialistët e IKTK-së, me Vendim nr.269, date 31.05.2018 të KKR-së. Ky projekt nuk eshte zbatuar. Për të vijuar me zbatimin e punimeve është i nevojshëm rishikimi i projektit te sipërcituar, i cili duhet të miratohet pranë KKT KM-së.	E plote	JO
1385	12.08.2021	Kerkese per informacion mbi venien ne dispozicion te dokumentacionit.	26.08.2021	Në vijim të kërkeses suaj, per vënien ne dispozicion te dokumentacionit me detajim per 8 projektet e investimeve nga Fondi i Rindërtimit per vitin 2020 dhe per 4 projektet per vitin 2021, Ju bëjme me dije se: Bazuar ne shkronjen "a" te pikës 3 te nenit 15 te Ligjit nr 119/2014 "Për t drejtën e informimit", shprehimisht : "Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme: a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze"; duke konsideruar volumin e madh te informacionit që kërkoni dhe githashtu mungesën e stafit në këtë periudhë kohe ne institucion, lutemi në mirëkuptimin tuaj per shtyerjen e marrjes se informacionit me 5 dite pune kohë.	Në proces.	JO
1385/2	02.09.2021	Plotesim pergjigje kerkeses me Nr.prot 1385 .	02.09.2021	Në vijim të kërkesës tuaj, lidhur me kërkesën për informacion rreth projekteve të investimeve nga Fondi i Rindërtimit, ju bëjmë me dije se: Alokimi i Fondit të Rindërtimit është realizuar në zbatim të VKM-së Nr.213 datë 11.03.2020 "Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore". Vlerat e pagesave për kontratat e vitit 2020 dhe 2021 janë publike dhe mund të aksesohen në faqen zyrtare të IKTK-së. Ju informojmë se nuk ka kontrata të papaguara. Gjithashtu, ju bëjmë dije se IKTK nuk disponon fonde për implementimin e projekteve, të gjitha procedurat, fondet e angazhuara për zbatimin e projekteve në kuadër të procesit të rindërtimit dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm, administrohen nga Ministria e Kulturës. Në lidhje me dokumentat standarde të procedurave të tenderit dhe termave të referencës për Hartim Projektet, lutemi gjeni link-un më poshtë: <a href="https://we.tl/t-OE81-b3Fbq8">https://we.tl/t-OE81-b3Fbq8</a> Sa i përket dokumenteve standarde dhe termave të referencës për "Hartim i Raporteve të Vëzhgimit Arkeologjik në 24 zonat e reja të zhvillimit" dhe "Kryerje dhe Hartim i Raporteve të Sondazheve Arkeologjike në 2 zonat e reja të zhvillimit", Ju bëjmë me dije se janë të aksesueshme online tek faqja zyrtare e APP.	E plote	JO



## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

1386	17.08.2021	Kerkese per informacion mbi banesen Monument Kulture kategoria e II-te.	30.08.2021	<p>Në vijim të email-it të datës, lidhur me kërkesën për informacion për objektin në Rrugën “Mihal Duri”, Nr.7, Zona Kadastrale Nr. 8380, në qytetin e Tiranës, Ju përcjellim: Vendimin Nr.521, datë 22.12.2020 të KKT/KM.</p> <p>Gjithashtu, sqarojmë se në afatin kohor të përmendur (2015-2020), Instituti i Monumenteve të Kulturës (sot IKTK) në bashkëpunim me DRKK Durrës (sot DRTK Tiranë), me qëllim përditësimin e kartelave të pasurive kulturore, kanë kryer në vitin 2018 inspektime në terren për objektet monument kulture të qarkut Tiranë, duke përfshirë edhe objektin me kod II-149.</p> <p>Ndërsa lidhur me Relacionin e hartuar nga Rest.Fatjon Saliu ju informojmë se referuar Ligjit Nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” dhe gjithashtu Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, jeni të lutur të kontaktoni me subjektin në fjalë.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni Vendimin Nr. 521 dhe kartelën e objektit të vitit 2018.</p>	E plote	JO
1386/1	17.08.2021	Delegim kerkese per informacion mbi banesen Monument Kulture kategoria e II-te nga MK.	30.08.2021	<p>Në vijim të email-it të datës, lidhur me kërkesën për informacion për objektin në Rrugën “Mihal Duri”, Nr.7, Zona Kadastrale Nr. 8380, në qytetin e Tiranës, Ju përcjellim: Vendimin Nr.521, datë 22.12.2020 të KKT/KM.</p> <p>Gjithashtu, sqarojmë se në afatin kohor të përmendur (2015-2020), Instituti i Monumenteve të Kulturës (sot IKTK) në bashkëpunim me DRKK Durrës (sot DRTK Tiranë), me qëllim përditësimin e kartelave të pasurive kulturore, kanë kryer në vitin 2018 inspektime në terren për objektet monument kulture të qarkut Tiranë, duke përfshirë edhe objektin me kod II-149.</p> <p>Ndërsa lidhur me Relacionin e hartuar nga Rest.Fatjon Saliu ju informojmë se referuar Ligjit Nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” dhe gjithashtu Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, jeni të lutur të kontaktoni me subjektin në fjalë.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni Vendimin Nr. 521 dhe kartelën e objektit të vitit 2018.</p>	E plote	JO
1387	17.08.2021	Delegim ankese nga MK.	19.08.2021	<p>Pershendetje, prane IKTK eshte administruar me Nr.13. Prot, datë 17.08.2021, ceshtja e percjelle nga Zyra e Bashkeqeverisjes Nr.362., ku vuhemi në dijeni të problematikës së znj. F. Mandili në lidhje me disa ndërhyrje në afërsi të banesës së saj në lagjen Pllakë, në qytetin e Gjirokastrës.</p> <p>Në vijim, kërkohet të bëni një verifikim në terren mbi pretendimet e Znj. F. Mandili dhe përcillni pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore një relacion të detajuar në mënyrë që të kthehet një përgjigje brenda afateve të percaktuara.</p> <p>Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopje të kërkesës, së bashku me foto të pozicionit të objektit.</p>	Deleguar DRTK Gjirokastrë	JO
1387/2	23.08.2021	Kthim pergjigje DRTK Gjirokastrë.	23.08.2021	<p>Në përgjigje të email tuaj mbi problemin e ngritur nga znj. F. Mandili, banuese në lagjen Pllakë të qytetit të Gjirokastrës pas verifikimit në vend të problemit konstatojmë;</p>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>Banesa e znj. F. Mandili me banesën e znj. N. Xhezo janë banesa pa status të ndodhura në lagjen Pllakë , janë ngjitur me njëra tjetrën duke lënë një hapësirë ndërmjet tyre rreth 100cm. Në vite këto dy banesa kanë patur ndryshime. Banesa e znj. F. Mandili është banesë 3 katëshe dhe është e banueshme, kurse banesa e znj. N. Xhezo është 2 katëshe dhe për momentin është e pabanueshme. Sipas informacionit të znj. F. Mandili banesa e znj. N. Xhezo të paktën para 10 vitesh ka qenë ne çati dhe më pas është hedhur soletë beton/arme me pretendimin se do të mbulohej me çati me rrasë guri gjë e cila sështë bërë. Kjo soletë nga ana e banesës së znj. F. Mandili ka një spreth rreth 40 cm ku kullojnë ujrat e soletës në mënyrë të pakontrolluar dhe krijojnë lagështi në anën e brendshme të mureve të banesës të znj. F. Mandili e cila ka kërkuar nga ana e znj. N. Xhezo që të vendosë ulluqe horizontale për mbledhjen e ujrave dhe ulluqe vertikale për mbledhjen e ujrave. Znj. N. Xhezo nuk i është përmbajtur premtimit të dhënë dhe znj. F. Mandili i është drejtuar Bashkisë Gjirokastrë dhe portalit për të gjetur zgjidhje. I kërkuam znj. F. Mandili dokumentacionin e nevojshme për vërtetimin e pronësisë por i ka në proces legalizimi. Sikundër shihet problemi nuk varet nga ne për t'u zgjidhur pasi është i mbartur dhe ne sygjerojmë ti drejtoheni gjykatës pasi nuk gjejnë mirëkuptim për zgjidhjen e problemit .</p>		
1394	19.08.2021	Kerkese per informacion lidhur me objektin me kod II-231.	25.08.2021	<p>Ne vijim te kerkeses Suaj, lidhur me kërkesën për informacion për objektin që mban kodin II-231 në hartën e qytetit të Tiranës, Ju bëjmë me dije se:</p> <p>Objekti në rrugën “Abdullah Gjinali”, e cila kryqëzohet me rrugën “Isa Boletini” në Tiranë, është objekt pasuri kulturore, monument kulture i kategorisë së II-të, me kod (II-231), shpallur me Urdhër Nr. 276 datë 16.07.2015 “Për shpalljen monument kulture të kategorisë së II-të të disa objekteve në qytetin e Tiranës”.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni një kopje të Urdhërit të sipërcituar.</p>	E plote	JO
1410	24.08.2021	Kërkesë për informacion lidhur me ndërhyrjet në objektin pasuri kulturore “ Banesa Fico” në Gjirokastrë.	08.09.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.1410 Prot., datë 23.08.2021, lidhur me informacion për ndërhyrjet në objektin pasuri kulturore “<i>Banesa Fico</i>” në qytetin e Gjirokastrës, Ju bëjmë me dije se në arkivin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore administrohen projektet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Projekti i restaurimit i vitit 1978;</li> <li>- Projekti i restaurimit vitit 2010;</li> <li>- Relacion dhe preventiv i ndërhyrjes prekonsoliduese në tavanin e pikturuar të banesës Fico.</li> </ul> <p>Në lidhje me kërkesën për kryerjen e një rivlerësimi të gjendjes aktuale të konservimit shkaktuar nga rrëzimi i murit në pjesën e pasme në këtë objekt pasuri kulturore, IKTK në bashkëpunim me DRTK Gjirokastrë do të kryejnë në terren një inspektim dhe do të vijojnë me hartimin e një projekti të plotë për ndërhyrje restauruese.</p> <p>Bazuar në Ligjin Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 20, mbi Financimin për Trashëgiminë Kulturore, Ju duhet të drejtoheni me kërkesë pranë Ministrisë së Kulturës.</p>	E plote	JO
1432	26.08.2021	Kerkese ankese per banesen ne Vuno/Himare.	17.09.2021	<p>Pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore është administruar kërkesa me Nr. 14.. Prot., datë 25.08.2021, e Znj. V. Curra, në lidhje me ndërhyrjet pa leje të kryera nga komshiu i saj Z. M. Varfi në vitet 2000, në</p>	Deleguar per kompetence Bashkise	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>fshatin Vuno. Bashkëlidhur kërkesës, qytetarja na vë në dispozicion të gjithë korrespondencën e kryer me Bashkinë Himarë, Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Institutin e Monumenteve të Kulturës (sot IKTK) në lidhje me këtë çështje.</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Ju informojmë se:</p> <p>Fshati Vuno gëzon statusin “qendër historike” me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 30, datë 20.01.2016. Ndërtimi i kryer nga Z. M. Varfi daton mes viteve 2004-2005, kohë në të cilën, fshati nuk gëzonte statusin e sipërcituar.</p> <p>Bazuar në Nenin 3 të Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e Ndërtimit”, “Kontrolli e zbatimi i ligjshmërisë dhe i standartevë teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës kryhet nga Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik i bashkisë dhe nga Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik Kombëtar”.</p> <p>Gjithshtu, në mbështetje të VKM Nr. 894, datë 04.11.2015, pika 8: “IKMT-ja, në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor. Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare dhe në territor, në kuptim të ligjit, janë zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, pyjet dhe zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, përfshirë zonat me karakteristika unike gjeografike, zonat me rrezik natyror, rrjetet ekologjike, burimet minerare e natyrore e rrjetet, komplekset dhe parqet industriale, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe infrastruktura ndihmëse, instalimet e infrastrukturës kombëtare, sektori i energjisë dhe komunikimit elektronik, aeroportet, portet e rrugët detare, zhvillimet në zonat ushtarake, vija bregdetare, brigjet dhe burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqenet, digat e dambat, tokat bujqësore, spitalet publike, objektet dhe terrenet sportive, si dhe ato të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit e me akte nënligjore ose ligje të tjera.”</p> <p>Me shkresë Nr. 1731/1 Port., datë 02.09.2019, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ka përcjellë për trajtim pranë institucioneve Tuaja kërkesën e Znj. V. Curra, së bashku me dokumentacionin e paraqitur në këtë të fundit.</p> <p>Për sa më sipër, Ju drejtohem që të trajtoni edhe njëherë kërkesën e Znj. Curra, e cila nuk përfshihet në detyrat funksionale të IKTK-së dhe Ministrisë së Kulturës, por në kompetencën Tuaj në zbatim të legjislacionit të cituar më lart.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni shkresën Nr. 1731/1 Prot., datë 02.09.2021 dhe kërkesën e Znj. Curra, së bashku me dokumentacionin e depozituar prej saj.</p>	Himare, IKT, IKMT	
1445/1	30.08.2021	Delegim kerkese per informacion nga MK.	03.09.2021	<p>Në përgjigje te kërkesës tuaj, ju bejme me dije se: Fondacioni shqiptaro-amerikan i zhvillimit (AADF) nuk eshte institucion prane Ministrise se Kultures, por nje partner strategjik i cili ka financuar disa prej projekteve me madhore ne fushen e trashegimise kulturore ne Shqiperi. AADF eshte nje korporate jo-fitimpruresë e qeverisur nga nje bord administrimi qe operon teresisht ne Shqiperi. Sa me sipër, Projekti “Rikualifikimi ne zonen urbane prane qendres se qytetit Vlore: Hartim i projektit urban, restaurimi i</p>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				monumenteve të kultures ne kete zone dhe rikonstruksioni i objekteve te tjere”, Vlore eshte miratuar me Vendim KKR Nr 179, date 05.06.2017 si dhe me pas projekt zbatimi “ Zona A, Projekt rikualifikimi ne zonen urbane prane qendres se qytetit Vlore: Hartimi i projektit urban, restaurimi i monumenteve te kultures ne kete zone dhe rikonstruksion i objekteve te tjere”, eshte miratuar me Vendim KKR Nr 258, date 05.09.2017. Ne vijim ju informojme se Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore nuk eshte organ kompetent per trajtimin e kontratave te qiradhenjes midis pronarit dhe subjektit privat AlbStar.		
1447	30.08.2021	Delegim kerkese nga MK per informacion mbi xhamine e Kavajes.	03.09.2021	Në përgjigje të shkresës suaj, në lidhje me statusin e mbrojtjes së objektit “Portiku i Xhamisë Qëndër”, Bashkia Kavajë, Ju bëjmë me dije se: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore i është drejtuar me shkresë Nr. 4320/1, datë 25.08.2021 Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tiranë për verifikim të interesit kulturor për “Xhamia Qëndër”, Bashkia Kavajë. Bashkëlidhur gjeni shkresën e sipërcituar.	E plote	JO
1455	01.09.2021	Kerkese per informacion mbi banesen e Sami Abazit.	14.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje [ë dokumentacionit arkivor në format elektronik (CD), për objektin "Banesa e Mexhit Kokalari " në lagjen Palorto, në qytetin e Gjirokastrës.  Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë - Arkivi Teknik i IKTK	E plote	JO
1457	01.09.2021	Delegim kerkese per informacion nga MK.	07.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, mbi informacionin në lidhje me ndriçimin e jashtëm të 15, Ju dërgojmë bashkëlidhur materialet e arkivit me kod arkivi Nr. - <a href="http://we.tl/t-yMUGUWBXq3">http://we.tl/t-yMUGUWBXq3</a> , për projektin: “Hartimi I projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave: Kalaja e Bashtovës, Borshit, Durrësit, Elbasanit, Himarës, Kaninës, Kepit të Rodonit, Lezhës, Libohovës, Peqinit, Petrelës, Porto Palermos, Prezës, Shurdhahut, Tiranës”.	E plote	JO
1461	01.09.2021	Kerkese per materiale nga arkiva .	09.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë materialet e arkivit me kod arkivi Nr. -. <a href="https://we.tl/t-XQ08hswYMK">https://we.tl/t-XQ08hswYMK</a> , kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik , fotografik dhe përshkrimor për objektet në qarkun Dibër si më poshtë: - Banesa e "Elmaz Korb Muharremi”, në fshatin Gurë i Bardhë; Banesa e "Abdulla Zylfit", në fshatin Kurdari; Banesa e "Xhelal Bodes", në fshatin Gurë i Bardhë; Banesa e "Abdi (Veli Domit)", në fshatin Gurë i Bardhe; Banesa e "Shaqir (Elmaz) Dëzhgiut", në fshatin Gurë i Bardhë. Ju bëjmë me dije se nuk disponojmë materiale arkivore për banesën e "Rustem Dyle Çelës” dhe "Kullën e Allaman Canit”, në fshatin Patin, Kloş, Dibër.	E plote	JO
1463	01.09.2021	Kerkese per informacion .	15.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje të dokumentacionit arkivor fotografi negative nga fototeka për objektet në qytetin e Tiranës, realizuar në muajin gusht të vitit 1973 me autor H. Çollaku, me kod arkivi Nr. -. <a href="https://we.tl/t-XoxeGRYR87">https://we.tl/t-XoxeGRYR87</a> Si më poshtë: Negativi Nr. 14346, objekte në rrugën "Besim Imami", Negativi Nr. 14347, "Ish- shtëpia e Oficerëve", në rrugën "Konferenca e Pezës";	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				Negativi Nr. 14348, "Tsh- shtëpia e Oficerëve", në n-ugën "Konferenca e Pezës"; Negativi Nr. 14349, objekte në rmgën "Hamdi Deljallisi"• Negativi Nr. 14350, objekte në n-ugën "Hysen Dalliu". Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë - Arkivi Teknik i IKTK.		
1466	01.09.2021	Kerkese per informacion ne lidhje me disa vila monument kulture.	16.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj për t'u pajisur me informacion rreth disa objekteve në qytetin e Tiranës, Ju përcjellim:  Urdhrrat e Ministrisë për deklarimin e mungesës së interesit kulturore për pasuritë kulturore në Tiranë sipas listës së kërkuar; Vendimet e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve heqjen e statusit “monument kulture” sipas listës që vijon: 1. Vendim i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve Nr. 247, datë 18.12.2015; 2. Vendim i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve Nr. 297, datë 11.06.2018; 3. Vendim i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve Nr. 16, datë 11.01.2019; 4. Vendim i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve Nr. 211, datë 14.06.2019; 5. Vendim i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve Nr. 307, datë 18.09.2019; 6. Vendim i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve Nr. 359, datë 01.11.2019; 7. Vendim i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve Nr. 360, datë 01.11.2019; 8. Vendim i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale Nr. 521, datë 22.12.2020; Ju informojmë së për sa i përket objekteve të tjera referuar listës Tuaj, për të cilat nuk administrohen vendime të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, procedurat janë kryer në përputhje me ligjin Nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i shfuqizuar), Neni 24, pika 3. <i>“Hegja e plotë ose e pjesshme e mbrojtjes nga shteti e një objekti ose grupi objektiv të trashëgimisë kulturore është e drejtë ekskluzive e organit që e ka shpallur atë.”</i>  Lidhur me relacionet e hartuara nga persona fizikë, restauratorë të licensuar në trashëgimi përbëjnë dokumentacione me informacione që trajtohen në kufizimin e të drejtës së informimit dhe të drejtës së autorit. Bashkëlidhur gjeni Vendimet e sipërcituara dhe Urdhrrat e Ministrisë për listën e objekteve sipas kërkesës.	E plote	JO
1471	02.09.2021	Kerkese per kopjine vendimesh te KKTKM.	02.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, ju dërgojmë bashkëlidhur vendimet si më poshtë :  1. Vendim i KKTKM Nr. 10, datë 15.01.2021 2. Vendim i KKTKM Nr. 478, datë 09.12.2020 3. Vendim i KKTKM Nr. 476, datë 09.12.2020 4. Vendim i KKTKM Nr. 477, datë 09.12.2020.	E plote	JO
1478	02.09.2021	Kerkese per informacion .	15.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : Ministria e Kulturës ka dërguar pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në UNESCO ftesë zyrtare për një mision monitorimi reaktiv për gjendjen e konservimit të qendrave historike Berat dhe Gjirokastrë. Pranë Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të saj të varësisë nuk është depozituar asnjë deklaratë apo korrespondencë zyrtare nga ekspertë vendas apo të huaj. Shteti shqiptar është njoftuar nga ana e QTB-së se UNESCO ka marrë gjatë vitit 2021 vazhdimisht nga palë të treta informacion anonim mbi zhvillimin e punimeve për ByPass Gjirokastrë. Ky informacion ka qenë në	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				formën e pamjeve fotografike nga kantieri i ndërtimit, të cilat kanë qenë objekt i korrespondencave midis shtetit palë dhe QTB-së. Ndërtimi i ByPassit do të zgjidhë në rradhë të parë problemin e trafikut të automjeteve në Qendrën Historike dhe kryesisht në zonën e Pazarit Gjirokastër. Gjithashtu, i jep zgjidhje përfundimtare lëvizjes së automjeteve dhe këmbësorëve nga rruga Nacionale dhe Lagja Punëtori në drejtim të zonës Historike. Kryesisht zgjidh problemin për lagjet e sipërme të qytetit, Dunavat i parë dhe Dunavat i dytë, si dhe do të lehtësojë trafikun dhe aksesimin për lagjet Cfaqë dhe Manalat. Mendohet se ndërtimi i Bypassit do të lehtësojë dukshëm ngarkesën e trafikut për lagjet Partizani dhe Palorto, si dhe ngarkesën në aksin Bashtea e Teqesë, deri Granica.		
1480	02.09.2021	Kerkese per informacion rreth “Rrenojes se Kishes se Shen Marise, Mamurras, Kurbin.	19.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Për objektin pasuri kulturore, Rrënojat e kishës së Shën Mërisë, Mamurras, Kurbin, janë miratuar 2 projekte si në vijim: 1. Projekt-ide “Plani i konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në objektin pasuri kulturore dhe muze: “Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras, Kurbin; 2. Projekt-zbatim “Plani i konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në 4 objekte pasuri kulturore “Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras, Kurbin”, Informacionet e nevojshme lidhur me vlerën dhe operatorin ekonomik, përfaqësuar nga “FOCUS Architecture” shpk, i gjeni në faqen zyrtare të IKTK në linkun e mëposhtëm: <a href="http://iktk.gov.al/site/informacion-mbi-buxhetin-dhe-te-dhenat-financiare-te-ap/">http://iktk.gov.al/site/informacion-mbi-buxhetin-dhe-te-dhenat-financiare-te-ap/</a> Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Neni 6, pika 3: “Pronarët dhe poseduesit e pasurive kulturore në pronësi private, përfshirë bashkësitë fetare të njohura zyrtarisht, kanë detyrimin të garantojnë ruajtjen e këtyre pronave dhe vlerave që ato mbartin dhe të bashkëpunojnë me institucionet publike të specializuara për të kryer mbrojtjen, vlerësimin dhe aksesin në pasuritë kulturore.” IKTK nuk disponon fonde për realizimin e mirëmbajtjes apo restaurimin e kësaj kishe.	E plote	JO
1480/2	20.09.2021	Kerkese/ankese per informacion .	27.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : Projekti “Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras, Kurbin” është pjesë e Projektit “Plani i konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në 4 objekte pasuri kulturore”, ku vetëm vlera e projektit të kishës është 900.000 (nëntëqind mijë) Lekë pa tvsh. Operatori ekonomik fitues është “FOCUS Architecture/Ave Consulting/ Comfort 96/ AR-MI Projektim Mbikqyrje/ Altea and Geostudio 2000”.	E plote	JO
1484	07.09.2021	Kerkese per informacion mbi projektet e vitit 1940-1960 Durres.	20.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Duke qenë se formacioni i kerkuar për ndërtesat në Durrës, përfshin një periudhë disa vjecare, dosjet e përgatitura sipas viteve, përmbajnë një volum të konsiderueshëm dokumentacioni, dhe si e tillë nuk mund t’jua përcjellim në formë elektronike apo me poste. Lutemi nga ana juaj të paraqiteni pranë IKTK-së, në kohën që ju mendoji të përshtatshme (çdo ditë 08;00-16;30 dhe të premte 08;00 deri në orën 14;00), për të aksesuar dokumentacionin pranë bibliotekës/arkivit. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

1500	09.09.2021	Ankese per ndertim pa leje ne Berat.	14.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, ju bëjmë me dije se : Përsa më sipër, kërkohet nga ana Juaj një vlerësim në terren i situatës dhe hartimi i një relacioni të detajuar, i cili do të përcillet pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.  Bashkëlidhur gjeni kopje të shkresës.	Deleguar DRTK Berat	JO
1509	10.09.2021	Kerkese per foto te gurit te varrit te Xhamise Mbret ne Berat.	21.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur me kod arkivi Nr. - <a href="https://we.tl/t-01IM9qCCKZ">https://we.tl/t-01IM9qCCKZ</a> , kopje të dokumentacionit arkivor fotografik nga fototeka për objektin Xhamia Mbret, në qytetin e Beratit : Negativi me Nr. 412 realizuar në vitin 1966 nga R. Veseli. Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë - Arkivi Teknik i IKTK.	E plote	JO
1510	10.09.2021	Delegim ankese nga MK	14.09.2021	Në përgjigje të email-it të datës 09.09.2021, dërguar nga Ministria e Kulturës, ku është përcjellë çështja Nr. 373554 e Platformës Së Bashkëqeverisjes, vihemi në dijeni të problematikës Së Z.R. Koço në lidhje me nevojën për punime mirëmbajtjeje në banesën e tij ne lagjen "Kala", ne qytetin e Beratit. Në vijim, kërkohet të bëni një verifikim në terren në objektin me vendndodhje në lagjen "Kala" dhe përcillni pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore një relacion të detajuar. Bashkëlidhur po Ju dërgojmë kopje të kërkesës Së administruar në IKTK. Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.	Deleguar DRTK Berat	JO
1520	14.09.2021	Kerkese per ndihme/fonde per restaurimin e baneses se tij ne Diber-Vernice	28.09.2021	Në vijim të kërkesës Suaj, lidhur me problematikën e gjendjes së konservimit dhe mungesës së fondeve për restaurimin e objektit pasuri kulturore, monument kulture të kategorisë së I-rë “Banesa e Kosta Markut”, në fshatin Vërnice, Dibër. Përsa më sipër, kërkohet nga ana Juaj një vlerësim në terren i gjendjes së konservimit të objektit dhe hartimi i një relacioni të detajuar, i cili duhet të përcillet pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Bashkëlidhur gjeni kopje të kërkesës.	Deleguar DRTK Tirane .	JO
1521	14.09.2021	Kerkese per materiale nga arkiva per dyqanin e Rakos ne Pazarin e Korçës.	14.09.2021	Ne vijim te kerkeses Suaj , ju vendosim në dispozicion bashkelidhur ne link dokumentacionin arkivor teknik me kod arkivi Nr. - <a href="https://we.tl/t-q9fj7quIXx">https://we.tl/t-q9fj7quIXx</a> Per objektin “Dyqani i Rakos” ne Pazarin e Korçes, si me poshte:  1. Gen-Plan; 2. Planimetri e katit I; 3. Planimetri e Katit III; 4. Pamje ballore; 5. Pamje e deres se ballkonit; 6. Pamje e kolones metalike; 7. Planimetri dhe pamje e ballkonit.	E plote	JO
1522	14.09.2021	Delegim kerkese/ankese per ndertimin ne Gjirokastrer nga MK.	17.09.2021	Në vijim të email-it të datës 13.09.2021 nga Ministria e Kulturës ku është përcjellë çështja Nr. 362... e Platformës së Bashkëqeverisjes, administruar në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr.1522 Prot., datë 14.09.2021, vihemi përsëri në dijeni të problematikës së znj. F. Mandili në lidhje me disa ndërhyrje në afërsi të banesës së saj në lagjen Pllakë, në qytetin e Gjirokastrës.	Deleguar per kompetence DRTK Gjirokastrër	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p>Në përgjigjen e datës 20.08.2021, Ju përmendni se problematika e Znj. F. Mandili është shkaktuar nga ndërhyrjet e Znj. N. Xhezo në banesën e saj. Ju drejtohem sërish për trajtimin e këtij rasti me qëllim sqarimin e kushteve të kryerjes së ndërhyrjeve të realizuara në këto banesa dhe nëse këto ndërhyrje janë në bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore. Bashkëlidhur po Ju dërgojmë kopje të kërkesës së administruar në IKTK, së bashku me foto të pozicionit të objektit.</p>		
1523	14.09.2021	Delegim kerkese per informacion mbi Kalane e Prezes .	22.09.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Vlera e kontratës së projektit: “Hartim Projekti “Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 5 objekte pasuri kulturore (Ura e Kurcajt në Perroin e Zerzës, Krujë; Kalaja e Bashtoves, Rrogozhinë; Kalaja e Prezës (Kulla e Sahatit dhe Kulla Verilindore) Prezë; Kalaja e Lezhes-Park arkeologjik; Kalaja e Krujës (Kulla e Sahatit dhe muret e fortifikimit), Krujë.) <b>ku vetëm për objektin “Kalaja e Prezës (Kulla e Sahatit dhe Kulla Verilindore) Prezë”, duke qënë një nga monumentet i cili u demtua më rëndë nga tërmeti, është 19,500,000 lekë.</b></p> <p>Nga tërmeti i datës 26 Nentor 2019, një numër i konsiderueshëm i pasurive kulturore pësuan dëmtime strukturore duke rrezikuar vlera të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore. IKTK në bashkëpunim me DRTK-të përkatëse kryen kontrollin e të gjitha objekteve me status pasuri kulturore. Vlerësimi i demit ishte paraprak, duke u mbështetur vetëm në vlerësimin viziv, pa kryer analiza apo testime të specializuara. Në vijim, në një fazë më të avancuar, me qëllim evitimin e mbivendosjes së projekteve si dhe në kushtet ku IKTK ka evidentuar dhe objekte të tjera të trashëgimisë kulturore që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente, kemi kërkuar për ndryshimin e këtyre objekteve me objekte të tjera për të cilat nevojitet ndërhyrje.</p> <p>Me Vendim Nr. 478, datë 09.12.2020, KKTKM vendosi të miratojë propozimin për ndryshimin e projekteve, në kuadër të procesit të rindërtimit, për objektet e kontratës së shërbimeve: Nr. 1814/11 Prot, dt.09.10.2020 për hartim projekti <b>“Plani i konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në 5 objekte pasuri kulturore”, zëvendësim i objektit “Kulla e Sahatit dhe Kulla Verilindore”, me objektin “Xhamia në Kalanë e Prezës”.</b></p> <p>Pas dakortësimit me Operatorin Ekonomik që kjo kontratë do të realizohej pjesërisht, hartimi i projektit për këtë objekt nuk do të procedohej. Sa më sipër, OE është paguar pjesërisht (pa përfshirë “Kulla e Sahatit dhe Kulla Verilindore në Kalanë e Prezës”), në vlerën 73,000,000 lekë.</p> <p>Në vitin 2021, fondi limit i vendosur në dispozicion nga Buxheti i Shtetit në kuadër të procesit të rindërtimit për objektin <b>“Hartim “Plani i Konservimit, Ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në objektin: Kalaja e Prezës (përfshirë Xhaminë në Kalanë e Prezës, duke përfshirë 2 Kullat dhe murin verilindor të Kalasë)” është 22,400,138.</b></p> <p>Projektet e ndërhyrjeve për restaurim ose për studim janë financuar nga Buxheti i Shtetit, me Vendim Nr. 213, datë 11.03.2020 <i>“Për caktimin e Institutit</i></p>	E plote	JO



## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

				<p><i>Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/ rindërtimit të pasurive kulturore” dhe me donatorë të ndryshem te huaj.</i></p> <p>Implementimi i projekteve me fonde nga donatorë të huaj i përket vetë donatoreve. IKTK nuk ka fonde.</p> <p>Përsa i përket pyetjeve referuar fondit të donacioneve për restaurimin e monumenteve të dëmtuara nga tërmeti, kush janë donatorët dhe sa kanë dhuruar secili prej tyre, ju bëjme me dije se informacioni është kompetencë Ministrise se Kulturës.</p>		
1528	15.09.2021	Kerkese per materiale nga arkivi .	28.09.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik dhe përshkrimor me kod arkivi Nr. -</p> <p><a href="https://we.tl/t-F3Hn61KI8N">https://we.tl/t-F3Hn61KI8N</a>  <a href="https://we.tl/t-dLYMIFyt7E">https://we.tl/t-dLYMIFyt7E</a>  <a href="https://we.tl/t-lfEN4bUZZW">https://we.tl/t-lfEN4bUZZW</a></p> <p>për objektet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- “Kisha e Manastirit të Shën Kollit”, në fshatin Mesopotam, bashkia Finiq;</li> <li>- “Kisha e Shën e Premtës”, në fshatin Çetë, bashkia Kavajë.</li> </ul> <p>Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).</p>	E plote	JO
1532	15.09.2021	Kerkese per informacion ne lidhje me disa objekte .	21.09.2021	<p>Në vijim të email-it Tuaj, Ju bëjmë me dije se:</p> <p>Objekti me emërtimin "Banesa ku është mbledhur Komiteti Kombëtar për mbrojtjen e Kosovës " mban statusin pasuri kulturore, monument kulture i kategorisë së I-rë, shpallur me shkresë Nr.670 Prot., datë 12.08.1981.Objekti me emërtimin "Kulla e Mic Sokolit", mban statusin pasuri kulturore, monument kulture i kategorisë së I-rë, shpallur me shkresë Nr. 1886, datë 10.06.1973, të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës.</p> <p>Në arkivin e IKTK-së administrohen projektet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Projekt rikonstruksioni "Godina ku është formuar Komiteti i Kosovës, Shkodër", hartuar nga IKTK dhe DRTK Shkodër dhe miratuar me Vendim të KKR, Nr. 1 datë 30.03.2012;</li> <li>-Projekt restaurimi "Kulla e Mic Sokolit", hartuar nga DRTK Shkodër dhe miratuar me Vendim tëKKR, Nr. 150, datë 21.03.2018;</li> <li>-Projekt "Restaurimi i gatisë së banesës së Mic Sokolit", hartuar nga DRTK Shkodër dhe miratuar me Vendim KKR, Nr.346, datë 27.07.2018.</li> </ul> <p>Në vijim, Ju informojmë se IKTK nuk disponon informacion në lidhje me statusin e pronësisë për objektet e sipërcituara.</p> <p>Më poshtë link-un ku mund të aksesoni projektet e lartpërmendura.</p> <p><a href="https://we.tl/t-nRSVwzpyYR">https://we.tl/t-nRSVwzpyYR</a></p>	E plote	JO
1537	15.09.2021		23.09.2021	<p>Ne pergjigje te kerkeses Suaj date 14.09.2021, administruar ne Institutin Kombetar te Trashegimise Kulturore me Nr. 1537 Prot., date 15.09.2021, bashkelidhur lutem gjeni dokumentacionin e dorezuar nga ana Juaj te skanuar me date 26.12.2019.</p>		
1544	16.09.2021	Kerkese per materiale nga arkiva.	23.09.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit arkivor fotografik me kod arkivi Nr. - <a href="https://we.tl/t-LVxtun5IKS">https://we.tl/t-LVxtun5IKS</a></p> <p>për objektin me kod Nr. 931 “Shkolla e parë e vajzave”, në qytetin e Korçës. Fotot historike janë realizuar nga z. H. Collaku, në vitin 1978.</p> <p>Sa më sipër, Ju bëjmë me dije se nuk disponojmë dokumentacion grafik apo përshkrimor për këtë objekt.</p>	E plote	JO

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021

1556	17.09.2021	Delegim kerkese per informacion nga APP.	29.09.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : gjeni në tabelat bashkëngjitur informacionin e kërkuar mbi procedurat e konkurrimit publik që Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) ka kryer në periudhën 2020-2021: objekti i prokuruar, fondi limit, vlera e kontratës, operatorët pjesëmarrës në konkurrim dhe operatori ekonomik fitues.</p> <p>Gjithashtu, gjeni në CD bashkëngjitur termat e referencës dhe DST – të për këto procedura. Lloji i procedurës ligjore që është ndjekur është “Shërbime Konsulence”, sipas formatit të “Lidhja 2”, të Udhëzimit nr. 269, datë 11.08.2020 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar.</p> <p>Përsa i përket dokumentave të tenderit dhe kontratave respektive, këto materiale nuk mund të përcillen për sa kohë përmbajnë të dhëna sensitive të operatorëve ekonomikë. Kjo bazuar në paragrafin vijues të nenit 17, Ligji “Për të drejtën e informimit”, i cili parashikon se “Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuara në shkronjat ‘a’, ‘b’, ‘c’ dhe ‘ç’, të kësaj pike, nuk zbatohen kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ....”.</p>	E plote	JO
1579	21.09.2021	Kerkese per informacion materiale nga arkivi.	28.09.2021	<p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të vjetër arkivor grafik dhe përshkrimor me kod arkivi Nr. -</p> <p><a href="https://we.tl/t-cwazPkDVJZ">https://we.tl/t-cwazPkDVJZ</a>  <a href="https://we.tl/t-lfEN4bUZZW">https://we.tl/t-lfEN4bUZZW</a>  <a href="https://we.tl/t-y5O2nuCsZ4">https://we.tl/t-y5O2nuCsZ4</a></p> <p>për objektet në bashkinë e Beratit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- “Kisha e Shën Gjergjit”, në lagjen “Kala”;</li> <li>- “Kisha Fjetja e Shen Merise (Katedralja), në lagjen “Kala”;</li> <li>- “Kisha e Shen Spiridhonit”, në lagjen “Goricë”.</li> </ul> <p>Sa më sipër, lutemi për çdo dokument të përdorur te citohet burimi nga është marrë (Arkivi Teknik i IKTK).</p>	E plote	JO
1587	22.09.2021	Delegim kerkese per informacion nga MK .	29.09.2021	<p>Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se : gjeni në tabelën bashkëngjitur informacionin e kërkuar mbi procedurat e konkurrimit publik që Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) ka kryer në periudhën 2020-2021: objekti i prokuruar, fondi limit, vlera e kontratës, operatorët pjesëmarrës në konkurrim dhe operatori ekonomik fitues.</p> <p>Gjithashtu, gjeni në CD bashkëngjitur termat e referencës dhe DST – të për këto procedura. Lloji i procedurës ligjore që është ndjekur është “Shërbime Konsulence”, sipas formatit të “Lidhja 2”, të Udhëzimit nr. 269, datë 11.08.2020 “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar.</p> <p>Përsa i përket dokumentave të tenderit dhe kontratave respektive, këto materiale nuk mund të përcillen për sa kohë përmbajnë të dhëna sensitive të operatorëve ekonomikë. Kjo bazuar në paragrafin vijues të nenit 17, Ligji “Për të drejtën e informimit”, i cili parashikon se “Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuara në shkronjat ‘a’, ‘b’, ‘c’ dhe ‘ç’, të kësaj pike, nuk</p>	E plote	JO



**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK – SHTATOR 2021**